

Pas përkujdesjes nuk e mbulojmë kërthizën dhe i vështrojmë komplikimet eventuale.

Kërthiza le të jetë sa më pak e mbuluar dhe e ajrosur (konform temperaturës së ambientit). Shtratin e kërthizës pas rënies së kordonit umbelikal nuk e mbulojmë, pasi që kjo vetëm se e zgjatë kohën e terjes së kërthizës. Për një terje optimale pelena le t' mos mbuloj kërthizën në asnjë fazë deri në shërimin e plotë. Preferohet që veshjet e të sapolindurit në muajin e parë t'i lajmë veças nga veshjet tjera, aq më tepër bëjmë edhe shpëlarjen shtesë të tyre.

Larja e të sapolindurit

Zakonisht kordoni umbelikal bie brenda 5. deri 14. ditësh. Kjo kohë mund të jetë më e gjatë tek të lindurit me prerje cesare, tek të lindurit e parakohshëm, të sapolindurit e dobësuar si dhe tek përdorimi i medikamenteve antiseptike për kujdes ndaj kërthizës. Pas rënies së kordonit umbelikal në shtratin e kërthizës paraqitet një plagë relativisht e freskët, e cila gradualisht shërohet brenda 12. deri 15. ditësh. Gjatë kësaj kohe zakonisht paraqitet një tajtje e lehtë ngjyrë e verdhë si dhe kohë pas kohe pikon gjak. Deri në këtë kohë bëhet vetëm se larja shtratore.

Kësisoj të sapolindurin mund ta lajm vetëm se pasi që kërthiza krejtësisht të shërohet, e që zakonisht kjo ndodhë gjatë javës së 2. dhe të 3. të moshës.

Kur duhet ta vizitojmë mjekun?

Nëse përreth kërthizës paraqitet skuqja e lëkurës, të ënjturit, qelbi me një kundërmim të lehtë, nëse me të prekur i dhemb kërthiza fëmijës, nëse paraqitet gjakderdhja si dhe nëse kordoni umbelikal edhe pas 14. ditësh nuk ka rënë ende, do të thotë se shërimi nuk është si duhet.

Të gjitha ndryshimet duhet paraqitur motrës medicinale të patronazhit. Është me shumë rëndësi, që të sapolindurin ta kontrolloj mjeku brenda afatit të duhur.

Burimet: Kujdesi për kërthizën e fëmijës së sapolindur. www.prvikoraki.si, Protokoli nacional i kujdesit shëndetësor të kërthizës së fëmijëve të sapolindur me shtojcën e vitit 2018



Oda e kujdesit shëndetësor të mamive të Sllovenisë - Asociacioni i shoqatave profesionale të motrave medicinale, mamive dhe teknikëve shëndetësor të Sllovenisë



Seksioni i motrave medicinale dhe teknikëve shëndetësor në pediatri

Fletëpalosja është bërë në mbështetje të idesë së Grupit punues të motrave medicinale brenda kornizave të Seksionit të motrave medicinale dhe teknikëve mjekësor në pediatri. Të gjitha motrave medicinale dhe mjekëve, të cilët kanë dhënë kontribut në këtë brendi, ju falënderohemi tej mase.

NEGA NOVOROJENČKOVEGA POPKA navodila za starše

PËRKUJDESI PËR KËRTHIZËN E TË SAPOLINDURIT udhëzime për prindër

Kryesorja tek përkujdesja e kërthizës është ruajtja e pastërtisë dhe gjendjes së terur. Që në fillim tek i sapolinduri shohim trungun e freskët të kordonit umbelikal, të shtrënguar me kapëse. Trangu i kordonit umbelikal thahet dhe bije pas 5. deri 14. ditësh. Pas shërimit mbetet i dukshëm shtrati i kërthizës, i cili shërohet gradualisht brenda 12. deri 15. ditësh.

Në ditën e parë, pas ardhjes nga materniteti, të sapolindurin dhe prindërit i viziton motra medicinale e patronazhit, e cila do ju ofron ndihmën lidhur me shërimin e kërthizës. Do të ju ndihmoj në përkujdesje të sapolindurit edhe në thithje. Është shumë e rëndësishme që t'i respektoni udhëzimet e saja. Të mirëseardhura janë edhe pyetjet tuaja.

Me që kërthiza është një plagë e freskët, paraqet pikë hyrëse për infektimin e të sapolindurit. Njëra nga masat më të rëndësishme në parandalimin e infektimeve është **HIGJIENA E DUARVE.**

KUR DUHET LARË DUART TEK KUJDESI I KËRTHIZËS?

Duart duhet larë mirë e mirë para çdo përkujdesjeje të kërthizës. Para larjes së duarve duhet larguar orën, byzylykun dhe unazat. Duart i lajmë mirë e mirë me ujë të ngrohtë rrjedhës dhe sapun, i shpërlajmë mirë dhe i terim. Duart duhet larë gjithmonë kur vërejmë se janë të ndotura si dhe pas ndërrimit të pelenave të foshnjës, pas kollitjes, fshirjes së hundëve si dhe pas përdorimit të mjeteve elektronike siç janë telefoni, tastiera dhe kompjuterët bartës, sepse janë përplot me mikrobe.

KU DHE SI E PËRGATISIM HAPËSIRËN E PËRKUJDESIT PËR KËRTHIZËN?

Temperatura e dhomës le të jetë midis 24 °C dhe 26 °C, në hapësirë le të mos ketë shkujë. Sipërfaqja, ku e vendosim foshnjën, le të jetë e pastër. Mbi të le të jetë e ndarë pjesa e pastër dhe ajo e papastër, pra pajisjet e pastra në një rënë anë si dhe gjërat e përdorura në anën tjetër.


VLERËSOJMË DUKJEN E KËRTHIZËS DHE BËJMË PASTRIMIN SIPAS UDHËZIMEVE

Fotografia 1. Vetitë e kërthizës së shëndoshë, kërthizës me risk dhe kërthizës së sëmurë.

Burimet: Kujdesi për kërthizën e të sapolindurit. www.prvikoraki.si


KËRTHIZA E SHËNDOSHË (të gjitha të cekurat):

- mungesa e skuqjes, e të ënjturit, çelbjes dhe erës kundërmuese,
- mungesa e gjakderdhjes së shumtë,
- mungesa e granulomit apo indit të ngjashëm me granulomin,
- koha e rënies së kordonit umbelikal më e shkurt se dy javë,
- rrjedhja më pak se dy javë pas rënies së kordonit umbelikal.



KËRTHIZA ME RISK (së paku njëra nga të cekurat):

- skuqja pa të ënjtur, çelbja dhe era kundërmuese,
- koha e rënies së kordonit umbelikal më e gjatë se dy javë,
- rrjedhja më shumë se dy javë pas rënies së kordonit umbelikal.



KËRTHIZA E SËMUAR (së paku njëra nga të cekurat):

- skuqja, të ënjturit, çelbja e rrjedhjes dhe era kundërmuese,
- gjakderdhje e fortë,
- granulomi apo indi i ngjashëm me granulomin.



CILAT MJETE NDIHMËSE JANË TË DUHURA TEK PËRKUJDESJA PËR KËRTHIZËN E TË SAPOLINDURIT?

- palosëset e sterilizuara ose tamponat,
- 0,9 % të tretjes fiziologjike (për një pastrim të kërthizës, nuk e ruajmë),
- sipas nevojës edhe mjete antiseptike, që nuk kanë alkool në përbërje.

SI DHE SA HERË DUHET TË PËRKUJDESEMI PËR KËRTHIZËN?

Kujdesemi për një komoditet dhe ndjesi të mirë të foshnjës, le të jetë e shtrirë në shpinë, në sipërfaqe të sigurt dhe të butë. Nëse pelena është e ndotur me jashtëqitje apo urinë, e pastrojmë dhe e mbështjellim, i lajmë duartë si dhe pastaj përkujdesemi për kërthizën.

Nëse pelena është e ndotur me jashtëqitje apo urinë, e pastrojmë dhe e veshim, i pastrojmë duartë si dhe kujdesemi për kërthizën.

1. Për pastrimin e **kërthizës së shëndoshë** përdorim **tretjen fiziologjike 0,9 %** dhe e pastrojmë mirë kërthizën **njëherë në ditë** si dhe sipas nevojës, nëse është e ndotur. Pas kujdesit bëjmë terjen e kërthizës me materialin e veçantë për tharje.

2. Për pastrimin e **kërthizës me risk dhe të sëmurë** përdorim **tretjen antiseptike** dhe e pastrojmë kërthizën **triherë në ditë** dhe sipas nevojës, nëse është e ndotur. **Antiseptikun nuk e terim, pasi që ai terët vetvetiu.**